| Të dhëna për organin i cili e përpunon dokumentin planor | |
|---|---|
| **Emërtimi i dokumentit planor** | Plani detal urbanistik për Bllokun 12, KK Dibër- 1, Komuna Dibër, me periudhë planifikimi 2020- 2025. |
| **Organi kompetent për përpunimin e dokumentacionit planor** | Shoqëria për plane hapësinore dhe urbanistike, inxhinering etj. GOPLAN ShPK- Gostivar. |
| **Organi kompetent për sjelljen e dokumentit planor** | Këshilli i Komunës Dibër |

| Të dhëna për përpunuesin e dokumentit planor | |
|---|---|
| **Emri i personit të autorizuar për përgaditjen e dokumentit planor** | Jaser Çajali, i.d.a.<br>Umnije Aziri, i.d.a.<br>Nasuf Saiti, i.d.n. |
| **Emërtimi i vendit të punës** | Jaser Çajali- planer<br>Umnije Aziri- bashkëpunëtor<br>Nasuf Saiti- bashkëpunëtor |
| **Të dhëna kontakti për personin** | Rr. Beliçica pn, 1230 Gostivar.<br>e-mail: go-plan@hotmail.com<br>Tel. 042/ 50 54 04 |

| Të dhëna bazike për dokumentin planor | | | |
|---|---|---|---|
| **Nga se rrjedh sjellja e këtij dokumenti planifikues? (psh. detyrim ligjor ose dispozitë tjetër)** | | | |
| Plani detal urbanistik për Bllokun 12- Dibër, punohet në pajtueshmëri me nenin 11 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), ndërsa përgatitet në bazë të:<br>- Programit përpërpunimin e planeve urbanistike në Komunën Dibër;<br>- Plan programit në pajtueshmëri të nenin 26 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18);<br>- Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18);<br>- Rregullores për përmbajtjen më të afërt, formën dhe mënyrën e përpunimit të planit gjeneral urbanistik, planit detal urbanistik, planit urbanistik për fshat, planit urbanistik për jashtvendbanime dhe planit regullativ të planit gjeneral urbanistik, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e përpunimit të dokumentacioneve urbanistiko- planore dhe projektin arkitektoniko-urbanistik dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e përpunimit të projektit për infrastrukturë (Gaz. zyrtare e RM nr. 142/15);<br>- Rregullores për standarte dhe normativa për planifikim hapësinor (Gaz. zyrtare e RM nr. 142/15, 217/15, 222/15, 228/15, 35/16, 99/16, 134/16, 33/17 dhe 86/18). | | | |
| **Sillet dokument i ri planor apo kryhet ndryshim i atij egzistues?** | | | |
| Po ☐<br>Jo X | | | |
| **Nëqoftëse kryhet ndryshim i dokumentit planor egzistues theksojeni emërimin e dokumentit planor të vjetër dhe arsyet e ndryshimit të saj?** | | | |
| - PDU për Dibrën, të miratuar me Vendim nr. 09-2510/1 data 16.07.1990;<br>- PDU për pjesë të yonës qëndrore të qytetit- lokaliteti "Venec 1" pjesë e bllokut urban 12- (2007-2012), të miratuar me Vendim nr. 07-1033/3 data 13.11.2017;<br>- PDU për pjesë të yonës qëndrore të qytetit- lokaliteti "Venec 2" pjesë e bllokut urban 12, 13 dhe 14, (2007- 2012)- të miratuar me Vendim nr. 07-1097/6 data 29.11.2013;<br>- PDU për pjesë të BU 12 Dibër- lokaliteti Venec 1- (2014- 2019) të miratuar me Vendim nr. 07-71/5 data 27.01.2015;<br><br>Plani punohet me qëllim që të mundësohet sigurimi i kushteve më humane për jetesë dhe punë për qytetarët, shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të hapësirës, mbrojtje të paluajtshmërive kulturore dhe mbrojtje dhe përparim të mjedisit jetësor dhe natyrës. Planifikimi urbanistik mundëson rritjen e nivelit të jetesës humane dhe përmirësimit të kushteve për jetesë, harmonizim dhe humanizim të hapësirës, me dispozita planore të cilat sjellin standarde më të larta në lidhje me planin e mëparshëm. | | | |
| **A po përfshin dokumenti planor zonë të definuar me nenin 65 alinea 2 nga Ligji për mjedisin jetësor? Nëqoftë se përgjigja është PO theksojeni zonën.** | | | |
| Jo. | | | |
| **A është i përcaktuar dokumenti planor me dekretin për strategjitë, planet dhe programet, përfshirë edhe ndryshimet e atyre strategjive, planeve dhe programeve, për të cilat detyrimisht zbatohet procedurë për vlersimin e ndikimit të tyre në mjedisin jetësor dhe në jetën dhe shëndetin e njerëzve. Nëqoftëse është përcaktuar theksojeni pikën dhe alinejën nën të cilën është përcaktuar. (psh. neni 3, pika 1, alinea 5).** | | | |
| | | | |
| Po<br>Jo √ | Neni: / | Pika: / | Alinea: / |
| **A është planifikuar me dokumentin planor realizimi i ndonjë projekti i cili është parashikuar me Dekretin për përcaktimin e projekteve dhe kriteriumeve mbi bazën e të cilave përcaktohet nevoja për kryerjen e një procedure të vlerësimit të ndikimit në mjedis jetësor. Nëse përgjigja është pozitive, tregoni se për çfarë projekti bëhet fjalë.** | | | |
| Jo. | | | |
| **A përfshin dokumenti planor përdorimin e një zone të vogël me rëndësi lokale siç përcaktohet në nenin 65 paragrafi 3 të Ligjit për mjedisinin jetësor. Nëse përgjigjja është PO, specifikoni sipërfaqen e zonës dhe rrëndësinë e saj.** | | | |
| Jo. | | | |
| **Të tregohet qëllimi i sjelljes të dokumentit planor dhe të përshkruhet vendimi kyç që do të sillet.** | | | |

| |
|---|
| Qëllimi kryesor i përgatitjes së planit të detajuar urbanistik është rregullimi dhe organizimi i hapësirës përmes:<br>- Përcaktimit të parcelave ndërtimore,<br>- Planifikimit të parcelave ndërtimore,<br>- Përcaktimit të parametrave për madhësinë e sipërfaqes për ndërtim, bazuar në normat e planifikimit.<br>- Përcaktimi i sistemit të shërbimit të infrastrukturës të përmbajtjeve të planifikuara,<br>- Lidhja e lokacionit me energji elektrike, etj. infrastrukturë.<br><br>Përpunimi i PDU- së ka qëllimin përfundimtar përmes:<br>- përdorimit racional të tokës<br>- Përshtatja maksimale e infrastrukturës dhe ndërtesave me terrenin<br>- formimin e një tërësie të njohur ambientale dhe kulturore,<br>- respektimin dhe mbrojtjen e të drejtës së njeriut për punë<br>- respektimin dhe përmirësimin e vlerave të peizazhit<br>- formimi i një peizazhi kulturor<br>- respektimin dhe valorizimin e trashëgimisë kulturore ndërtimore<br>- ngritja e njerëzimit në hapësirë dhe lëvizjes së pandërprerë të njerëzve të hendikepuar,<br>- përfshirjen e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë natyrore<br>- instalimi i masave të mbrojtjes dhe shpëtimit<br>- respektimi i rregulloreve, standardeve dhe normativave ligjore në planifikim,<br>- të përcaktojë parametrat dhe udhëzimet për të gjitha përmbajtjet në përfshirjen planore në bazë të të cilave duhet të përpunohet Dokumentacini projektues i duhurt në përputhje me regulloren ligjore në fuqi, si dhe ti përshkruarë kushtet e veçanta dhe të përgjithshme projektuso- planore, përmes parametrave të kërkuar të cilat janë të nevojshme për përgatitje të projekteve themelore të ndërtimit, kur në parcelën ndërtimore konkrete është përcaktuar një sipërfaqje për ndërtim, ose përgatitja e PAU kur përcaktohet një sipërfaqje ndërtimi në një parcelë ndërtimore, për të cilin do të përcaktohen kushtet për vendosjen e disa ndërtesave, sipas parametrave të caktuara. |
| **Fushëveprimi i dokumentit planor. (psh. transport, planifikim i hapësirës dhe ngjajshëm.)** |
| Planifikim i hapësirës |
| **Periudha për sjelljen e dokumentit planor.** |
| 2020-2025. |
| **Parashihet revizion i dokumentit planor. Nëse është parashikuar revidim, në sa vite?** |
| Varet nga dinamika dhe shkalla e realizimit (5 vite). |
| **Hapësira ose zona e përfshirë me dokumentin planor. (psh. zona gjeografike, është mirë që të bashkangjitni hartë).** |
| Blloku 12, si njësi më e vogël e tokës ndërtimore, e caktuar për planifikim të detajuar me me Planin gjeneral urbanistik i qytetit të Dibrës, me sipërfaqje prej 16.18 ha është me kufijtë i cili kalon në aksin e rrugëve:<br>- Veri- rr. “Urfi Agolli” (SO4- sipas PGjU);<br>- Jug- juglindje- Qarkorja jugore- degëzimi nga R- 418 (R1201- Strugë- Dibër);<br>- Lindje- verilindje- rr. “8 Shtatori” (M1- sipas PGjU);<br>- Perëndim- rr. “E re e planifikuar” (SE16 sipas PGjU); |
| **Qëllimet dhe/ose propozim qëllimet që duhet të arihen me realizimin e dokumentit planor dhe a janë ata të përmbajtura në akt ose dokument.** |
| Po √<br>JO |
| **A është bashkangjitur kopje e qëllimeve?** |
| Po ☐<br>Jo √ |

<table>
<tr><td colspan="2"><u>Rezyme e ndikimeve mbi mjedisin jetësor</u><br>(Të specifikohet nëse implementimi i dokumentit planor do të shkaktojë ndikim të konsiderueshëm në mjedisin jetësor, duhet që t'i mbushni pyetjet që vijojnë më poshtë si udhëzim për përcaktimin e ndikimeve të rëndësishme të efekteve në mjedisin jetësor, të cilat janë në pajtueshmëri me Dekretin për kriteriumet mbi bazën e të cilave sillen vendimet nëse dokumente planore të caktuara mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndikimet potenciale në mjedisin jetësor nga dokumenti planor.<br>Me PDU për Bllok 12 në lëndë janë përcaktuar klasat vijuese të destinimit:<br>- A1- Banim në shtëpi banimi;<br>- A2- Banim në ndërtesa banimi;<br>- B1- Destinime të vogla komerciale dhe afariste;<br>- V1- Arsim dhe shkencë;<br>- V2- Shëndetësi dhe mbrojtje sociale;<br>- D1- Gjelbërim parku;<br>- D2- Gjelbërim mbrojtës;<br>- D3- Sport dhe rekreacion;<br>- E1- Infrastrukturë komunale;<br>- E2- Suprastrukturë komunale;<br><br>Burimet e mundshme të ndotjes së mediumeve dhe zonave të mjedisit jetësor do të përpunohen në shtojcë gjatë përgatitjes së dokumentacionit të projektit, me masa për mbrojtje planifikuese të përcaktuara qartë.</td></tr>
<tr><td>Probabiliteti, kohëzgjatja, frekuenca dhe kthyeshmëria e ndikimeve;</td><td>Dokumenti planor nuk do të ketë ndikim negative në mjedisin jetësor.<br>Me realizimin e dokumentit planor do të arrihet shfrytëzueshmëri dhe rregullim racional të hapësirës.</td></tr>
<tr><td>Natyra kumulative e ndikimeve në mjedisin jetësor dhe jetën dhe shëndetin e njerëzve;</td><td>Nuk priten ndikime kumulative në jetën dhe shëndetin e njerëzve.</td></tr>
<tr><td>Natyra ndërkufitare e ndikimeve;</td><td>Nuk ka.</td></tr>
<tr><td>Reziqet në jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisit jetësor (psh. si rezultat i fatkeqësive);</td><td>Reziku nga reziqet mbi shëndetin e njerëzve ose mjedisit jetësor mund të paraqiten si rezultat i fatkeqësive, zjareve ose havarive:<br><br>Prandaj duhet zbatimi i detyrueshëm i:<br>1. Masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor, dhe atë:<br>- Masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor;<br>- Masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit;<br>- Masave për mbrojtjen e ujërave;<br>- Masave për mbrojtjen e të vjelave<br>- Masave për mbrojte nga zhurma;<br>- Masave për menaxhimin me mbetjet;<br>2. Masave për mbrojtje dhe shpëtim;<br>- strehimin;<br>- mbrojtje dhe shpëtim nga përmbytjet;<br>- mbrojtje dhe shpëtim nga yjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme;<br>- mbrojtje nga masat joshpërthyese dhe mjetet e tjera shpërthyese;<br>- mbrojtje dhe shpëtim nga rrënojat;<br>- mbrojtj dhe shpëtim nga fatkeqësitë tekniko- teknologjike;<br>- mbrojtje dhe shpëtim nga rrëshqitja e dheut;<br><br>Masat humanitare janë:</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | - evakuimi;<br>- kujdesje e popullatës së rrezikuar dhe të prekur;<br>- mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike;<br>- ndihma e parë mjekësore;<br>- mbrojtje dhe shpëtim të shtazëve dhe prodhimeve me origjinë shtazore;<br>- mbrojtje dhe shpëtim të bimëve dhe prodhimeve me origjinë bimore; |
| **Përfshirja dhe vëllimi hapësinor i ndikimeve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë e cila do të preket).** | Lokaliteti gjendet në zonën e qytetit të Komunës së Dibrës.<br>Toka është në korniza të rajonit ndërtimor të qytetit Bllok 12.<br>Sipërfaqja e përfshirjes planore ëshë 16,18 ha (161762.2319 m²).<br>Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave ndërtimore në kuadër të përfshirjes planore është 108012,81 m².<br>Sipërfaqja maksimale për ndërtim (nën objekt) në kuadër të pëfshirjes planore është 53184,99 m².<br>Sipërfaqja maksimale e përgjithshme zhvillimore në kuadër të përfshirjes planore është 225932,51 m².<br>Numri i planifikuar i familjeve është 500.<br>Numri i planifikuar i banorëve është 2000.<br>Perimetri hapësinor nuk do të ketë ndikim në mjedisin jetësor. |
| **Ndikimet potenciale ekonomike dhe sociale që do t'i shkaktonte dokumenti planor siç janë:** | |
| Nga pikëpamja ekonomike, plani parashikon një rritje të sipërfaqes për ndërtim në përfshirjen e planit në fjalë. Me atë rritet përdorimi i hapësirës, fitohet dendësi neto për banor më e shfrytëzueshme, më shumë komunale për komunën, dhe sistemi i infrastrukturës ka një rritje të vogël në krahasim me dokumentacionin e planifikimit të mëparshëm, bëhet shfrytëzim racional i tokës dhe inkorporimi maksimal i objekteve dhe infrastrukturës me terrenin.<br>Nga pikëpamja sociale, me realizimin e këtij plani rritet kualiteti i hapësirës, fitohet rregullim estetik i haësirës dhe formulohet një pejsazh i ri dhe bashkëkohor urban dhe rriten të ardhurat. Me këtë rritet vlera e zonës që do të përfshihet nga miratimi i dokumentit të planifikimit. | |
| **Vlera dhe cënueshmëria e zonës e cila do të preket me sjelljen e dokumentit planor:**<br>Përderisa nuk do ketë ndikim në mjedisin jetësor, cënueshmëria e zonës që do të preket është e padukshëm.<br>Vlera: Me realizimin e këtij plani rritet vlera e zonës e cila do të pëfshihet me sjelljen e këtij dokumentacioni planor nga aspekti ekonomik dhe social. | |
| **Karakteristika të veçanta natyrore ose trashëgimi kulturore** | - Në bazë të Studimit për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, të përgatitur për nevojat e Planit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë, në zonën që i nënshtrohet Planit të detajuar urbanistik për Bllokun 12, KK Dibër 1, Komuna Dibër, me periudhën e planifikimit 2020- 2025, nuk është regjistruar e as nuk është evidentuar trashëgimi natyrore.<br>- Nga Ministria e Kulturës, Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është siguruar shkresë me nr 17-4196/2 data 26.12.2019, sipas së cilës në përfshirjen planore në fjalë nuk ka të mira të mbrojtura, e as të mira për të cilat supozohet që paraqesin trashëgimi kulturore. |
| **Tejkalimi i standardeve të cilësisë së mjedisit jetësor ose vlerave kufitare.** | Nuk ka ndikim në mjedisin jetësor dhe nuk ka tejkalim të vlerave kufitare. |
| **Shfrytëzimi intenziv i tokës** | Toka mbi të cilën do të ndërtohet paraqet tokë ndërtimore.<br>Toka ndërtimore në ndarjen parësore është e ndarë në:<br>- Tokë e parcelizuar ndërtimore për ndërtim të veçantë dhe shfrytëzim dhe,<br>- Tokë e paparcelizuar ndërtimore për shfrytëzim të përgjithshëm.<br><br>Në përfshirjen planore, toka ndërtimore e parcelizuar përbëhet nga 190 (njëqind e nëntëdhjetë) parcela ndërtimore, si njësi më të vogla dhe |

<table>
<tr><td></td><td>themelore të tokës ndërtimore.<br>Toka e paparcelizuar është toka për përdorim të përgjithshëm: rrugë, shtigje, gjelbërim parku dhe mbrojtës, ku janë planifikuar linjat e tjera infrastrukturore, ujësjellësi, kanalizimi, elektro- energjetike, elektronike etj.<br>Destinimi i tokës me PDU rregullohet në nivelin e parcelës ndërtimore, me Sistemin e e klasave të destinimit, në pajtueshmëri me nenin 28 të Rregullores për standarde dhe normativa për planifikim urbanistik ( Gazeta zyr. e RM nr. 142/15, 217/15, 222/15, 35/16, 99/16, 134/16, 33/17, 86/18).<br>Në përfshirjen planore janë përcaktuar grupet e klasave të destinimit në vijim:<br>A- banim;<br>B- destinime komerciale dhe afariste;<br>V- institucione publike;<br>D- gjelbërim, sport, rekreim dhe hapësira memoriale;<br>E- infrastrukturë;<br><br>Klasat themelore të destinimit:<br>A1- banim në shtëpi banimi;<br>A2- banim në ndërtesa banimi;<br>B1- destinime të vogla komerciale dhe afariste;<br>V1- arsim dhe shëndetësi;<br>V2- shëndetësi dhe mbrojtje sociale;<br>D1- gjelbërim parku;<br>D2- gjelbërim mbrojtës;<br>D3- sport dhe rekreacion;<br>E1- infrastrukturë komunale;<br>E2- suprastrukturë komunale;</td></tr>
<tr><td>Ndikimet në zonat apo peisazhet që kanë të njohur statusin e zonave të mbrojtura kombëtare ose ndërkombëtare.</td><td>Nuk ka.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Shpjegoni masën në të cilën dokumenti planor paraqet kornizë për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të tjera, në aspektin e vendndodhjes, natyrës, madhësisë dhe kushteve të operimit ose në aspektin e shpërndarjes së resurseve:<br>Me dokumentacionin planor nuk parashikohet ndërtimi i objekteve ose plane të tjera për te cilat është parashikuar zbatim i procedurës për vlersim të ndikimit në mjedisin jetësor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Shpjegoni rrethinën pranë projektit, gjegjësisht aktivitetin që është planifikuar të zbatohet me dokumentin planor në aspektin e ndikimeve të mundshme në mjedisin jetësor. (psh. plani parashikon ndërtimin e ndërtesave të banimit pranë një zone industriale, shpjegoni nëse zona industriale do të ketë ndikim në mjedisin jetësor tek projektet rezidenciale të planifikuara):<br>- Përfshirja planore gjendet në kuadër të rajonit ndërtimor të definuar me Planin gjeneral urbanistik të qytetit të Dibrës nga 2004- 2014, në kuadër të Planit detal urbanistik për Bllokun 12, KK Dibër 1, Komuna Dibër, me periudhë planifikimi 2020- 2025, për të cilin është zbatuar vlerësim strategjik për ndikim në mjedisin jetësor dhe pët të njejtën është marrë mendim pozitiv nga Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor.<br>- Lokaliteti gjendet në zonën e qytetit të Dibrës. Lokaliteti ndodhet në kuadër të rajonit ndërtimor të qytetit, Bllok 12. Plani parashikon ndërtimin e objekteve për banim në shtëpi banimi- A1, banim në ndërtesa banimi- A2, destinime të vogla komerciale dhe afariste- B1, arsim dhe shkencë- V1, mbrojtje shëndetësore dhe sociale- V2, gjelbërim parku- D1, gjelbërim mbrojtës- D2, sport dhe rekreacion- D3, infrastrukturë komunale- E1, suprastrukturë komunale- E2, por në afërsi të tyre nuk parashikohet ndërtimi I objekteve të cilat mund të kenë ndikim në mjedisin jetësor tek objektet e planifikuara në përfshirjen e dokumentacionit planor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Shpjegoni rëndësinë e dokumentit planor për përfshirjen e aspektit për mbrojtjen e mjedisit jetësor në veçanti me qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm: (Të tregohet nëse</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **fushëveprimi i dokumentit planor kontribuon në qëndrueshmërinë dhe uljen e problemeve ekologjike. Psh. një plan infrastrukture mund të ketë ndikime më të madh në mjedis sesa një plan arsimor i planeve mësimore.)**<br>Dokumentacioni planor nuk ka të bëjë me aspektin e mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe as me ndonje medium ose sferë të saj. Nga aspekti i mirëmbajtjes sjellja e planit do të sjellë përfitime në organizimin e nevojshëm funksional- hapësinor të hapësirës dhe cilësi të përshtatshme për jetesë dhe shfrytëzim të së njejtës. |
| **Cilat probleme ekologjike janë relevante për dokumentin planor. Përshkruani përse të njejtat janë relevante dhe përshkruani natyrën dhe seriozitetin e tyre.**<br>**(Shpjegoni problemet që miratimi i dokumentit planor mund t'i shkaktojë ose të çojë në rritjen e tyre, problemet që mund të ngadalsojnë zbatimin e tij, si dhe problemet të cilat miratimi i dokumentit planor mund që t'i zgjidhë ose zvogëlojë.)**<br>Me këtë dokumentacion planor nuk priten ndikime negative të dukshme mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve. |
| **Shpjegoni se si dokumenti planor që shqyrtohet është i lidhur me dokument/e planore tjetër/ të tjera dhe në hierarkinë e planifikimit. Vendosni emrin/emrat e atij/atyre dokumenti/dokumenteve planor/e dhe tregoni ndikimet kryesore të atij/atyre dokumenti/eve planifikuese në mjedisin jetësor. Përcaktoni dallimet në vendimet kryesore që janë bërë me dokumentin përkatës të planifikimit dhe dokumentet e tjera të planifikimit që kanë qenë ose do të jenë subjekt i vlerësimit.**<br><br>Për përfshirjen e planit në fjalë nga dokumentacioni planor paraprakt egzistojnë:<br>- Plani gjeneral urbanistik i qytetit të Dibrës nga 2004- 2014, e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Dibër me nr. 07-27/4 data 18.02.2005;<br>- PDU për Dibrën, e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Dibër me nr. 09-2510/1 data 16.07.1990;<br>- PDU pjesë të zonës qëndrore të qytetit Dibër- lokaliteti Venec 1 pjesë e bllokut urban 12- (2007-2012), e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Dibër me nr. 07-1033/3 data 13.11.2007;<br>- PDU për pjesën qëndrore të qytetit- lokalitet Venec 2, pjesë nga blloku 12, 13 dhe 14, (2012- 2017) - e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Dibër me nr. 07-1097/6 data 29.11.2013;<br>- PDU për pjesë të BU 12 Dibër- lokalitet Venec- 1- (2014- 2019) e miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Dibër me nr. 07-71/5 data 27.01.2015<br><br>Ky dokument planor është punuar në bazë të Plani gjeneral urbanistik i qytetit të Dibrës nga 2004- 2014 dhe PDU në fuqi.<br>- Për ndikimin e dokumentacionit planor të Plani gjeneral urbanistik i qytetit të Dibrës nga 2004- 2014 në mjedisin jetësor është bërë vlerësim strategjik për ndikimit në mjedisin jetësor.<br>Në përfshirjen e dokumentacionit planor Plani detal urbanistik për Bllokun 12, KK Dibër- 1, Komuna Dibër, me periudhë planifikimi 2020- 2025, nuk parashihet zonë industriale e rëndë dhe ndotëse dhe objekte të tjera me veprimtari që në mënyrë të konsiderushme do ta ndotnin mjedisin jetësor.<br>Qëllimet e të gjitha dokumenteve planore të cekura janë të përshatura me qëllimet dhe përmbajtjet e planit dhe nuk ka ndryshim në vendimet kyçe. |
| **Nëse ndikimet e mundshme të vendimeve kyçe në dokumentin planor tashmë janë vlerësuar ose tashmë janë rishikuar në dokumente të tjera të planifikimit në një fazë më të hershme, përmbledhni konkluzionet kryesore të atij vlerësimi dhe si ata konkluzione janë përdorur në procesin e vendimmarrjes. Përshkruani nëse vlerësimi i kryer më parë është bërë në përputhje me gjetjet e fundit mbi ndikimet në mjedisin jetësor në mënyrë që e njejta të mund të përdoret në procesin e miratimit të dokumedntit ekzistues të planor.**<br>Ndikimet potenciale nga përfshirja në fjalë do të ishin lëndë për rishikim në Elaboratin për mbrojtje të mjedisit jetësor. |
| **Nëse ndikimet e mundshme nga vendimi kyç në këtë dokument planor do të vlerësohet në ndonjë fazë të mëvonshme të planifikimit në një nivel më të ulët, specifikoni se si do të siguroni që ndikimet e përcaktuara në këtë fazë në miratimin e dokumentit planor të merren parasysh gjatë marrjes së vendimit në fazat e mëvonshme (p.sh. po zbatohet një vlerësim strategjik i planit urbanistik, i cili parasheh ndërtimin e një objekti që i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor).** |

| | |
|---|---|
| Vendimi kyç në këtë dokument planifikimi në fazën e mëvonshme nuk parashikon ndërtimin e një objekti që i nënshtrohet një procedure të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. | |
| DEKLARATË | Deklarojmë se të dhënat e ofruara në këtë formular janë të sakta, të vërteta dhe të plota. |
| **Funksioni, emri dhe mbiemri dhe nënshkrimi i personit që e sjell dokumentin planor në emër të organit** | Kryetari i Komunës Dibër<br>Hekuran Duka |
| **Data***:* 06.05.2020<br>**Vendi***:* Dibër<br>Nr. 10-______/1 | V.V. |